



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 542/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e dates 27.11.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfyqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertes së operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr.REF-66080-07-21-2020, me objekt: *“Për Blerje Materiale Mjekësore “Kanjula Trakeotomie metalike (sipas përmasave të nevojshme)” për Shërbimin e ORL për 12 muaj”, me fond limit 8’716’667.50 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 08.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.*
- Ankimues:** “Lel-Medical” sh.p.k
Nj.B nr.2, Rruga Elbasanit, Vila 7, Sauk, Tirane
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibres Nr. 372, Tiranë
- Subjekti i interesuar:** “Fedos” sh.p.k
Njësia Administrative Nr.2, Rruga “Manol Konomi”, Ndërtesa nr.14, Hyrja 2, Ap.2 Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”,* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,* Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-66080-07-21-2020, me objekt: *“Për Blerje Materiale Mjekësore “Kanjula Trakeotomie metalike (sipas përmasave të nevojshme)” për Shërbimin e ORL për 12 muaj”, me fond limit 8’716’667.50 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 08.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza.*

II.2. Në datën 24.09.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------|------------------------------|
| 1. “Fedos” sh.p.k | 4.250.000 lekë, kualifikuar |
| 2. “Euromed” sh.p.k | 5.990.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “Lel-Medical” sh.p.k | 6.875.000 lekë, kualifikuar |
| 4. “Biometric Albania” sh.p.k | 7.450.000 lekë, skualifikuar |

II.3 Në datën 30.09.2020, operatori ekonomik ankimes "Lel-Medical" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e ofertes se subjektit "Fedos" sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

Shoqëria jone "LEL-Medical" Shpk, ka marr pjese ne proceduren e prokurimit te zhvilluar nga autoriteti juaj kontraktor: Procedure e Hapur (Prokurim Elektronik)- Marreveshje Kuader me nje OE mete gjitha kushtet e percaktuara, me afat 12 muaj nga lidhja e MK, me nr. REF-66080-07-21-2020, me objekt: Blerje Materiale Mjekesore "Kanjula Trakeotomie metalike (sipas permasave te nevojshme)" per Shsrbllnin e ORL per per 12 muaj, me fond limit: Viera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate Marreveshjes Kuader: 8 716 667.50 (Tete milion e shtateqhd e gjashtembedhjete mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtaie pike pesedhjete) leke pa TVSH. 9mimi per njesi: 34'866,67 (Tridhjete e kater mije e teteqind e gjashtedhjete e gjashte pike gjashtedhjete e shtats) leke pa TVSH., i zhvilluar me date 08-09-2020 Ora: 10:00.

Me date 24.09.2020 ne oren 18:57 jemi njoftuar me ane te sistemit te prokurimit elektronik mbi rezultatin e vleresimit te komisionit te vleresimit te ofertave, ku rezulton renditja/klasifikimi i operatoreve ekonomik pjesemarres ne kete procedure prokurimi si me poshte:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlerat e ofertuara	Refuzuar
1	"FEDOS" Shpk	4,250,000	Jo
2	"EUROMED" Shpk	5,990,000	Po
3	"Lei-Medical" Shpk	6,875,000	Jo
4	"BIOMETRIC ALBANIA" Shpk	7,450,000	Po

Te nderuar!

Ne lidhje me renditjen e mesiperrne te OE pjesemarres per kete procedure prokurimi, kundërshtojme kualifikimin e

OE "FEDOS" Shpk me argumentet si me poshte:

Me date 22-07-2020 eshte publikuar ne sistemin e prokurimit elektronik procedura e prokurimit e shpallur nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane: Procedure e Hapur (Prokurim Elektronik)- Marreveshje Kuader me nje OE mete gjltha kushtet e psrcaaktuara, me afat 12 muaj nga lidhja e MK, me nr. REF-66080-07-21-2020, me objekt: Blerje Materiale Mjekesore "Kanjula Trakeotomie metalike (sipas permasave te nevojshme)" per Sherbimin e ORL per per 12 muaj, me fond limit: Viera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate Marreveshjes Kuader: 8 716 667.50 (Tete milion e shtateqind e gjashtembedhjete mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate pike pesedhjete) leke pa TVSH. <;mimi per njesi:

34'866,67 {Tridhjete e kater mije e teteqind e gjashtedhjete e e gjashte pike gjashte · .. leke pa TVSH., i parashikuar per tu zhvilluar me date 17.08.2020 Ora: 10:00.

Me date 27.07.2020 me ane llogarise tone ne sistemin e prokurimit elektronike ne menune "kerkesat" konstatuam qe operatori ekonomik "FEDOS" Shpk ka paraqitur ankimes ne ane te formularit te ankeses ku ka ngritur pretendimet e tij per kete procedure prokurimi ne lidhje me kriteret e parashikuara ne DST dhe konkretisht me kriterin e prashikuar ne DST ne shtojcen 9, kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.3, germa 9 ku eshte kerkuar nga ana e AK: c) Kerkohet Autodeklarate CE/DC {Deklarate Konformiteti) per materialet mjekesore, nga ofertuesi (distributorUprodhuesi) per konformiteti me normat MDD 93/42/EC, dhe SSH EN ISO 5366:2016

Pajisje respiratore dhe anestezie • Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment· Tracheostomy tubes and connectors, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e dorezimit.

Ne lidhje me kriterin e mesiperme te parashikuar, OE "FEDOS" Shpk ka paraqitur argumentet e tij, ku me ane te cilave kerkon modifikimin e DST dhe heqjen e kriterit per paragjitjen e certifikates EN ISO 5366:2016, pasi eshte nje kerkes e ekzagjeruar dhe shkon pertej asaj se cfare eshte e nevojshme per realizimin e synimit duke e cilesuar kete kriter si kriter diskriminues nga ana AK. (bashkelidhur formularin e ankeses se OE "FEDOS" se paraqitur per kete procedure prokurimi ne lidhje me kriteret e DST, ankese te cilen OE "FEDOS" e ka ngakuar ne sistemin e prokurimit e/elektronik ku ne dhe cdo operator ljetar jemi njohur ne ane te menunese "kerkesat" ne llogaritje te APP-se, formula/r ankese i cili eshte publike ne faqen zyrtare te APP-se).

Nga veprimet e metejshme te autoritetit kontraktor QSUT, u konstatua qe pezulloi kete procedure prokurimi dhe ka shqyrtuar ankesen e mesiperme te OE "Fedos" Shpk, dhe me date 17.08.2020 AK QSUT ka ngarkuar shtojcen per modifikimin e DST, ku me ane te kesaj shtojce verehet se AK ka shtyre veteni daten per hapjen dhe dorezimin e ofertave nga data 17/08/2020 Ora: 10:10 qe ishte, eshte shtyre per ne daten 08/09/2020 ora 10:00, pra ne kete shtojce nuk ka asnje ndryshim tjeter pervec dates se zhvillimit te tenderit, cka nenkupton qe AK nuk i ka pranuar pretendimet e ngritura ne ankesen e OE "FEDOS" Shpk.

Pra, referuar sa me siper kuptohet qe OE "Fedos" Shpk i cili ka paraqitur ankesen e tij ku kundërshton kriterin e mesiperme per sa i perket certifikates EN ISO 5366:2016, nga fakti qe ky OE kundërshton kete kriter do te thote qe nuk disponon kete dokument (certifikates EN ISO 5366:2016).

Me daten 08.09.2020, ne oren 10:00 eshte zhvilluar procedura e prokurimit dhe me date 24.09.2020 ne oren

18:57 jemi njohur me vleresimin e ofertave me renditjen si me poshte:

<i>Nr.</i>	<i>Operatori Ekonomik</i>	<i>Vlerat e ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>1</i>	<i>"FEDOS" Shpk</i>	<i>4,250,000</i>	<i>Jo</i>
<i>2</i>	<i>"EUROMED" Shpk</i>	<i>5,990,000</i>	<i>Po</i>
<i>3</i>	<i>"Lei-Medical" Shpk</i>	<i>6,875,000</i>	<i>Jo</i>
<i>4</i>	<i>"BIOMETRIC ALBANIA" Shpk</i>	<i>7,450,000</i>	<i>Po</i>

Nga renditja e mesiperme rezulton qe operatori ekonomik "FEDOS" Shpk eshte i kualifikuar ne kete procedure prokurimi. Referuar sa me siper kemi argumentuar ku OE "FEDOS" Shpk i cili i cili ka kundërshtuar me ane te ankimit te paraqitur kriterin e parashikuar ne DST dhe konkretisht ne shtojcen 9, kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.3, germa 9 ku eshte kerkuar nga ana e AK: c) Kerkohet Autodeklarate CE/DC (Deklarate Konformiteti) per materialet mjekesore, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformiteti me normat MDD 93/42/EC, dhe SSH EN ISO 5366:2016 Pajisje respiratore dhe anestezie • Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment • Tracheostomy tubes and connectors, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e dorezimit, pretendim i cili rezulton qe nuk eshte pranuar nga ana e AK QSUT, ku ky i fundit ka vleresuar dhe kualifikuar kete OE pavaresisht faktit qe nuk ploteson kerkesat per kualifikim te parashikuara ne DST dhe konkretisht certifikates EN ISO

5366:2016. Fakti qe OE "Fedos" Shpk ka kundërshtuar këte kriter ne rruge administrative ligjore do te thote qe ky OE nuk e disponon këte dokument ose ka paraqitur dokument jo te rregullt.

Sa me siper referuam bazuar ne provat dhe faktet e sipercituara te cilat po ua bashkelidhim si dhe ne mbeshtefe te Ligjit 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, neni 55, Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshua neni 66, si dhe dokumentave te tenderit te publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik: ·

KERKOJME:

- Verifikimin mbi vertetesine nga oragani i leshimit te dokumentacionit se paraqitur nga OE "FEDOS" Shpk, konkretisht certifikaten EN ISO 5366:2016
- Skualifikimin e ofertes se paraqitur nga OE "FEDOS" pasi nuk ploteson te gjitha kerkesat e Autoritetit tuaj Kontraktor, duke bere publikimin e klasifikimit te ri ne faqen e APP-se.

II.4. N p rmjet shkrës nr. 2992/3 prot., dat  05.10.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer p rgjigje ankimesit si vijon:

“[...] .”

Pretendimet e Operatorit Ekonomik:

Operatori Ekonomik "Lel Medical Sh.p.k" ka pretendime ne lidhje me Shtojcen 9 -2.3 pika 9 Kerkohet Autodeklarate CE/DC (Deklarate Konformiteti) per materialet mjekesore, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformiteti me normat :MDD 93/42/EC,dhe SSH EN ISO 5366:2016Pajisje respiratore dhe anestezie - Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment - Tracheostomy tubes and connectors, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e dorezimit, ku sipas ankeses se depozituar nga operatori pretendohet se operatori ekonomik "Fedos" eshte vleresuar dhe kualifikuar pavarisisht faktit qe nuk ploteson kerkesat per kualifikim te parashikuara ne DST dhe konkretisht certifikates EN ISO 5366:2016,ku nisur nga ankesa e bere fillimisht nga ky operator i cili ka kundërshtuar këte kriter ne rruge administrative ligjore, do te thote qe ky operator nuke disponon këte dokument ose ka paraqitur dokument jo te rregullt.

Vendim i Autoritetit Kontraktor.

Referuar ankeses se bere nga Operatori Ekonomik "Lel Medical" shpk, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesa pasi shqyrtoi ankesen dhe administroi dosjen e kesaj procedure konstatoi se vertetesia e dokumentacionit te paraqitur nga OE Fedos ne SPE, specifikisht certifikata EN ISO 5366:2016 Pajisje respiratore dhe anestezie -Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment - Tracheostomy tubes and connectors, eshte ne formen e kerkuar nga DST dhe nga ligji.

OE "Fedos" ka dorezuar kopjen e perkthyer dhe te noterizuar, te vlefshme ne momentin e dorezimit, ne perputhje me kriteret e vendosura ne DST.

Per sa thame dhe argumentuam me siper Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vendos mospranimin e ankeses se Operatori Ekonomik "Lei Medical shpk te ngritura ne shkrës Nr.2992 prot. Date 29.09.2020..

II.5. N  dat n 12.10.2020 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankes  pran  Komisionit t  Prokurimit Publik, duke pretenduar:

“ Shoqeria jone "LEL-Medical" Shpk, ka marr pjese ne proceduren e prokurimit te zhvilluar nga autoriteti juaj kontraktor: Procedure e Hapur (Prokurim Elektronik) - Marreveshje Kuader me nje OE me te gjitha kushtet e percaktuara, me afat 12 muaj nga lidhja e MK, me nr. REF-66080-07-21-2020, me objekt: Blerje Materiale Mjekesore "Kanjula Trakeotomie metalike (sipas permasave te nevojshme)" per Sherbimin e ORL per per 12 muaj, me fond limit: Viera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate Marreveshjes Kuader: 8 716 667.50 (Tete milion e shtateqind e gjashtembedhjete mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate pike pesedhjete) Ieke pa TVSH. Cmimi per njesi: 34'866,67 (Tridhjete e kater mije e teteqind e gjashtedhjete e gjashte pike gjashtedhjete e shtate) leke pa TVSH., i zhvilluar me date 08-09-2020 Ora: 10:00.

Me date 24.09.2020 ne oren 18:57 jemi njoftuar me ane te sistemit te prokurimit elektronik mbi rezultatin e vleresimit te komisionit te vleresimit te ofertave, ku rezulton renditja/klasifikimi i operatoreve ekonomik pjesemarres ne kete procedure prokurimi si me poshte:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlerat e ofertuara	Refuzuar
1	"FEDOS" Shpk	4,250,000	Jo
2	"EUROMED" Shpk	5,990,000	Po
3	"Lei-Medical" Shpk	6,875,000	Jo
4	"BIOMETRIC ALBANIA" Shpk	7,450,000	Po

Pasi u njohem me renditjen e mesiperme nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane (QSUT), brenda afatit ligjor te parashikuar ne LPP, me ane te formularit standart te ankeses nr. 7 prot, date 29.09.2020 drejtuar AK QSUT, kemi kundershtuar kualifikimin e shoqerise "FEDOS" Shpk me argumentet perkatese si me poshte:

Ne lidhje me renditjen e mesiperme te OE pjesemarres per kete procedure prokurimi, kundershtojme kualifikimin e OE "FEDOS" Shpk me argumentet si me poshte:

Me date 22-07-2020 eshte publikuar ne sistemin e prokurimit elektronik procedura e prokurimit e shpallur nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane: Procedure e Hapur (Prokurim Elektronik)

- Marreveshje Kuader me nje OE me te gjitha kushtet e percaktuara, me afat 12 muaj nga lidhja e MK, me nr REF-66080-07-21-2020, me objekt: Blerje Materiale Mjekesore "Kanjula Trakeotomie metalike (sipas permasave te nevojshme)" per Sherbimin e ORL per per 12 muaj, me fond limit: Viera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate Marreveshjes Kuader: 8 716 667.50 (Tete milion e shtateqind e gjashtembedhjete mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate pike pesedhjete) leke pa TVSH. Cmimi per njesi: 34'866,67 (Tridhjete e kater mije e teteqind e gjashtedhjete e gjashte pike gjashtedhjete e shtate) leke pa TVSH., i parashikuar per tu zhvilluar me date 17.08.2020 Ora: 10:00.

Me date 27.07.2020 me ane llogarise tone ne sistemin e prokurimit elektronike ne menune "kerkesat" konstatuam qe operatori ekonomik "FEDOS" Shpk ka paraqitur ankimim ne ane te formularit te ankeses ku ka ngritur pretendimet e tij per kete procedure prokurimi ne lidhje me kriteret e parashikuara ne DST dhe konkretisht me kriterin e parashikuar ne DST ne shtojcen 9, kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.3, germa 9 ku eshte kerkuar nga ana e AK: c) Kerkohet

Autodeklarate CE/DC (Deklarate Konformiteti) per materialet mjekesore, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformiteti me normat MOD 93/42/EC, dhe SSH EN ISO 5366:2016 Pajisje respiratore dhe anestezië - Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment - Tracheostomy tubes and connectors, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e dorezimit.

Ne lidhje me kriterin e mesiperme te parashikuar, OE "FEDOS" Shpk ka paraqitur argumentet e tij, ku me ane te cilave kerkon modifikimin e DST dhe heqjen e kriterit per paraqitjen e certifikates EN ISO 5366:2016, pasi eshte nje kerkes e ekzagjeruar dhe shkon pertej asaj se cfare eshte e nevojshme per realizimin e synimit duke e cilesuar kete kriter si kriter diskriminues nga ana AK. (bashke/idhur formularin e ankeses se OE "FEDOS" se paraqitur per kete procedure prokurimi ne lidhje me kriteret e DST, ankese te cilen OE "FEDOS" e ka ngakuar ne sistemin e prokurimit elektronik ku ne dhe cdo operator ljetër jemi njohur ne ane te menunese "kerkesat" ne llogaritë tone te APP-se, formular ankese i cili eshte publike ne faqen zyrtare te APP-se).

Nga veprimet e metejshme te autoritetit kontraktor QSUT, u konstatua qe pezulloi kete procedure prokurimi dhe ka shqyrtuar ankesen e mesiperme te OE "Fedos" Shpk, dhe me date 17.08.2020 AK QSUT ka ngarkuar shtojcën per modifikimin e DST, ku me ane te kesaj shtojce verehet se AK ka shtyre vetem datën per hapjen dhe dorezimin e ofertave nga data 17/08/2020 Ora: 10:10 qe ishte, eshte shtyre per ne datën 08/09/2020 ora 10:00, pra ne kete shtojce nuk ka asnje ndryshim tjetër pervec dates se zhvillimit te tenderit, cka nenkupton qe AK nuk i ka pranuar pretendimet e ngritura ne ankesen e OE "FEDOS" Shpk.

Pra, referuar sa me sipër kuptohet qe OE "Fedos" Shpk i cili ka paraqitur ankesën e tij ku kundërshton kriterin e mesiperme per sa i perket certifikates EN ISO 5366:2016, nga fakti qe ky OE kundërshton kete kriter dote thote qe nuke disponon kete dokument (certifikates EN ISO 5366:2016).

Me datën 08.09.2020, ne orën 10:00 eshte zhvilluar procedura e prokurimit dhe me date 24.09.2020 ne orën 18:57 jemi njohur me vleresimin e ofertave me renditjen si me poshte:

<i>Nr.</i>	<i>Operatori Ekonomik</i>	<i>Vlerat e ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>1</i>	<i>"FEDOS" Shpk</i>	<i>4,250,000</i>	<i>Jo</i>
<i>2</i>	<i>"EUROMED" Shpk</i>	<i>5,990,000</i>	<i>Po</i>
<i>3</i>	<i>"Lei-Medical" Shpk</i>	<i>6,875,000</i>	<i>Jo</i>
<i>4</i>	<i>"BIOMETRIC ALBANIA" Shpk</i>	<i>7,450,000</i>	<i>Po</i>

Nga renditja e mesiperme rezulton qe operatori ekonomik "FEDOS" Shpk eshte i kualifikuar ne kete procedure prokurimi. Referuar sa me sipër kemi argumentuar ku OE "FEDOS" Shpk i cili i cili ka kundërshtuar me ane te ankimit te paraqitur kriterin e parashikuar ne DST dhe konkretisht ne shtojcën 9, kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.3, germa 9 ku eshte kerkuar nga ana e AK: c) Kerkohet Autodeklarate CE/DC (Deklarate Konformiteti) per materialet mjekesore, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformiteti me normat MOD 93/42/EC, dhe SSH EN ISO 5366:2016 Pajisje respiratore dhe anestezië - Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment - Tracheostomy tubes and connectors bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne

momentin e dorëzimit, pretendim i cili rezulton që nuk është pranuar nga ana e AK QSUT, ku ky I fundit ka vlerësuar dhe kualifikuar këtë OE pavarësisht faktit që nuk plotëson kërkesat për kualifikim të parashikuara në DST dhe konkretisht certifikates EN ISO 5366:2016. Fakti që OE "Fedos" Shpk ka kundërshtuar këtë kriter në rrugë administrative ligjore dote thote që ky OE nuk disponon këtë dokument ose ka paraqitur dokument jo të rregullt.

Në mbështetje të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" i ndryshuar, neni 46, neni 55, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 66, si dhe dokumentave të tenderit të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik, përbushim të gjitha kërkesat ligjore, ekonomike dhe teknike për kualifikimin e shoqërisë tone në këtë procedurë prokurimi si oferte të rregullt ligjore.

Për sa më sipër përmendëm, në formularin e ankesës drejtuar AK- QSUT, kemi kërkuar:

1. Verifikimin mbi vertetësinë nga organi i leshimit të dokumentacionit se paraqitur nga OE "FEDOS" Shpk, konkretisht certifikatën EN ISO 5366:2016

2. Skualifikimin e ofertes se paraqitur nga OE "FEDOS" pasi nuk plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit tuaj Kontraktor, duke bërë publikimin e klasifikimit të ri në faqen e APP-se."

II.6. Në datën 23.10.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr 1257/2 prot, shkresa e autoritetit kontraktor nr 2992/6 prot., datë 20.10.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Lel – Medical" sh.p.k. "1.Verifikimin mbi vertetësinë nga organi i leshimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE "FEDOS" Shpk, konkretisht certifikatën EN ISO 5366:2016

2. Skualifikimin e ofertes se paraqitur nga OE "FEDOS" pasi nuk plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit tuaj Kontraktor, duke bërë publikimin e klasifikimit të ri në faqen e APP-se", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 2.3."Kapaciteti teknik", gërma "ç" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:
ç) Kërkohet **Autodeklaratë CE/DC (Deklaratë Konformiteti)** për materialet mjekësore, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformiteti me normat MDD 93/42/EC, dhe **SSH EN ISO 5366:2016 Pajisje respiratore dhe anestezie - Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment - Tracheostomy tubes and connectors**, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Fedos” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër, përsa i përket kërkesës për çertifikatën ISO 5366:2016, ka paraqitur në SPE dokumentin me emërtimin AUT_ISO_DOK_CE__Garanci_TRANSACT.pdf, ku përfshihet dokumentacioni si më poshtë:

- *Autorizim prodhuesi të lëshuar nga Transact International në cilësinë e prodhuesit dhe eksportuesit të produkteve kirurgjikale në emër të shoqërisë ”Fedos” sh.p.k.;*
- *Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë për standartin 13485:2016 e kompanisë prodhuese Transact International me qëllimin Prodhues dhe eksportues i instrumentave kirurgjikale dhe dentare;*
- *Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë për standartin 9001:2015 e kompanisë prodhuese Transact International me qëllimin Prodhues dhe eksportues i instrumentave kirurgjikale dhe dentare;*
- *Çertifikatë për tub trakeal për standartin ISO 5366:2016 e kompanisë prodhuese Transact International në terma të projektimit, madhësisë, formës, materialit dhe lidhjes;*
- *Deklaratë konformiteti CE sipas këshillit të direktivave 93/42/EEC e kompanisë prodhuese Transact International;*
- *Çertifikatë vlerësimi CE e prodhuesit Transact International për të çertifikuar se produktet janë: Pajisje mjekësore (metalike, të ripërdorshme, pa pudër dhe që penetrojnë në trup).*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

”1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. *Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit*”.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të AK *“Kërkohet Autodeklaratë CE/DC (Deklarate Konformiteti) për materialet mjekësore, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformiteti me normat MDD 93/42/EC, dhe SSH EN ISO 5366:2016 Pajisje respiratore dhe anestezie - Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment - Tracheostomy tubes and connectors, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse origjinale ose fotokopje te përkthyer dhe te noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit”* ka paraqitur *”Çertifikatë për tub trakeal për standartin ISO 5366:2016 të kompanisë prodhuese Transact International në terma të projektimit, madhësisë, formës, materialit dhe lidhjes”*. Komisioni vëren se certifikata e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k për produktin (tub trakeal) nuk është e plotë në raport me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për këtë kriter të përcaktuara në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.”Kapaciteti teknik”, gërma ”ç” ku kërkohet “Pajisje respiratore dhe anestezie-Tub Trakeostemik dhe bashkuesit”. Kriteret kualifikuese të Autoritetit Kontraktor për këtë pike kanë një përmbajtje më të zgjeruar duke përfshirë përveç tubit trakeostemik edhe bashkuesit. Gjithashtu pas kërkesës së operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k drejtuar autoriteti kontraktor për heqjen e kriterit për paraqitjen e certifikates EN ISO 5366:2016, nga verifikimi në sistemin elektronik (SPE) vërehet se shtojca e publikuar nga Autoriteti Kontraktor nuk ka pasqyruar asnjë ndryshim në dokumentat e tenderit. Lidhur me këtë moment Operatori ekonomik Fedos sh.p.k do të thotë që i ka pranuar kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të Dokumentave të Tenderit. Nëse do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pas publikimit të shtojcës nga ky i fundit pa asnjë ndryshim, operatori ekonomik Fedos sh.p.k ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në KPP lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Sa më sipër operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k duhet të kishte paraqitur dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriteret kualifikuese të Autoritetit Kontraktor.

III.1.6. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi, në respekt të parimit të barazisë dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve parashikuar nga neni 2 gërma “c”

e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës bazisë, dhe mosdiskriminimit janë garantitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.7. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankues qëndron.

III.1.8. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për “2. Skualifikimin e ofertes se paraqitur nga OE "Fedos" sh.p.k pasi nuk ploteson te gjitha kerkesat e Autoritetit Kontraktor, duke bere publikimin e klasifikimit te ri ne faqen e APP-se”, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:

Pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi referuar gjykimit më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Lel-Medical” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-66080-07-21-2020, me objekt: “Për Blerje Materiale Mjekësore “Kanjula Trakeotomie metalike (sipas përmasave te nevojshme)” për Shërbimin e ORL për 12 muaj”, me fond limit 8’716’667.50 lekë pa tvsh, zhvilluar

- me date 08.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor të anullojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k duke e skualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Lel-Medical” sh.p.k.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1257 Protokolli,

Datë 12.10.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtares së Komisionit të Prokurimit Publik znj. Vilma Zhupaj (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtare e KPP shpreh mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, përsa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Lel-Medical” sh.p.k për sa i përket çështjes me Objekt: “Shfyqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr.REF-66080-07-21-2020, me objekt: “Për Blerje Materiale Mjekësore “Kanjula Trakeotomie metalike (sipas përmasave të nevojshme)” për Shërbimin e ORL për 12 muaj”, me fond limit 8’716’667.50 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Lel – Medical” sh.p.k. “1.Verifikimin mbi vertetesine nga organi i leshimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE “FEDOS” Shpk, konkretisht certifikaten EN ISO 5366:2016

2. Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “FEDOS” pasi nuk plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit tuaj Kontraktor, duke bërë publikimin e klasifikimit të ri në faqen e APP-se”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, gërma ”ç” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

ç) *Kërkohet Autodeklaratë CE/DC (Deklaratë Konformiteti) për materialet mjekësore, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformiteti me normat MDD 93/42/EC, dhe SSH EN ISO 5366:2016 Pajisje respiratore dhe anestezië - Tuba trakeostemik dhe bashkuesit ose EN ISO 5366:2016 Anaesthetic and respiratory equipment - Tracheostomy tubes and connectors, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Fedos” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër, përsa i përket kërkesës për certifikatën ISO 5366:2016, ka paraqitur në SPE dokumentin me emërtimin AUT_ISO_DOK_CE__Garanci_TRANSACT.pdf, ku përfshihet dokumentacioni si më poshtë:

- *Autorizim prodhuesi të lëshuar nga Transact International në cilësinë e prodhuesit dhe eksportuesit të produkteve kirurgjikale në emër të shoqërisë “Fedos” sh.p.k.;*
- *Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë për standartin 13485:2016 e kompanisë prodhuese Transact International me qëllimin Prodhuës dhe eksportues i instrumentave kirurgjikale dhe dentare;*

- *Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë për standartin 9001:2015 e kompanisë prodhuese Transact International me qëllimin Prodhues dhe eksportues i instrumentave kirurgjikale dhe dentare;*
- *Çertifikatë për tub trakeal për standartin ISO 5366:2016 e kompanisë prodhuese Transact International në terma të projektimit, madhësisë, formës, materialit dhe lidhjes;*
- *Deklaratë konformiteti CE sipas këshillit të direktivave 93/42/EEC e kompanisë prodhuese Transact International;*
- *Çertifikatë vlerësimi CE e prodhuesit Transact International për të çertifikuar se produktet janë: Pajisje mjekësore (metalike, të ripërdorshme, pa pudër dhe që penetrojnë në trup).*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

”1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e përcaktuar në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit, duke paraqitur çertifikatën ISO 5366:2016, sipas përcaktimit të bërë nga autoriteti kontraktor.

III.1.6. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.1.7. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “2. *Skualifikimin e ofertes se paraqitur nga OE "FEDOS" pasi nuk plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit tuaj Kontraktor, duke bere publikimin e klasifikimit të ri në faqen e APP-se*”, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:

III.1.7.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori për të gjithë kriteret në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotëson kriteret e vendosura në DST operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k, i kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.7.2. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përçaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;*”

III.1.7.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.7.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund

të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kriteresh.

III.1.7.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke iu referuar të gjithë kriterëve të veçanta të kualifikimit duke mos indentifikuar asnjë element konkret brenda kriterëve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

III.1.7.6. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indiqje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi çënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.7.7. KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Lel- Medical” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër gjykojmë se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k, në këtë procedurë prokurimi është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit per procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit me Nr.REF-66080-07-21-2020, me objekt: *“Për Blerje Materiale Mjekësore “Kanjula Trakeotomie metalike (sipas përmasave te nevojshme)” për Shërbimin e ORL për 12 muaj”*, me fond limit 8’716’667.50 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankesa e operatorit ekonomik “Lel- Medical” sh.p.k nuk duhet pranuar dhe Autoriteti kontraktor duhet të lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Anëtar
Vilma Zhupaj